



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.72

2004

21 tetor

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i Kuvendit nr.146, datë 4.10.2004	Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit Parlamentar për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias për përmirësimin e Kodit Zgjedhor, ngritur me vendimin e Kuvendit nr.134, datë 1.7.2004, i ndryshuar.....	5103
Vendim i Kuvendit nr.148, datë 7.10.2004	Për zgjedhjen e disa anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.....	5103
Vendim i KM nr.660, datë 8.10.2004	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga sistemi i ndërtimi i rrugës “Ibrahim Dinçi”, në bashkinë e Elbasanit	5104
Vendim i KM nr.662, datë 8.10.2004	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë së Kuçovës.....	5105
Vendim i KM nr.663, datë 8.10.2004	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit për vazhdimin e financimit të projektit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme.....	5106
Vendim i KM nr.668, datë 8.10.2004	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i varrezave publike, në bashkinë e Përrenjasit	5106

Vendim i KM nr.669, datë 3.10.2004	Për një shtesë në vendimin nr.617, datë 4.12.2002 të Këshillit të Ministrave "Për heqjen nga armatimi dhe përdorimi të një pjese të armëve, teknikës dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura dhe për asgjësimin ose çmontimin dhe shitjen e tyre", të ndryshuar.....	5107
Vendim i KM nr.670, datë 8.10.2004	Për një ndryshim në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave "Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.....	5108
Vendim i KM nr.673, datë 15.10.2004	Për shpallje ditë zie kombëtare	5108
Vendim i GJK nr.14, datë 15.10.2004	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.3103, datë 11.7.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.276, datë 4.3.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1929, datë 16.12.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit);- Pezullimin e zbatimit të vendimeve të mësipërme.....	5109
Vendim i KKRT nr.267, datë 30.9.2004	Për dhënie licence për radio vendore private "Sport".....	5111
Vendim i KKRT nr.268, datë 30.9.2004	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat "Star".....	5112
Vendim i KKRT nr.269, datë 30.9.2004	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat "Egnatia kabël".....	5112
Vendim i KKRT nr.270, datë 30.9.2004	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat "Iliria".....	5113
Vendim i KKRT nr.271, datë 30.9.2004	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat "Lissus".....	5113
	Shpallje kërkesë për shpronësim me objekt "Shpronësimin e pronarëve që preken nga sistemimi i shkarjeve në kilometrin 89 Hotolisht, të ndodhura në segmentin rrugor Librazhd-Qukës".....	5114
	Shpallje kërkesë për shpronësim me objekt "Shpronësimin e pronarëve që preken nga rehabilitimi i shkarjeve në Barmash, të ndodhura në segmentin rrugor Ersekë-Leskovic".....	5114

VENDIM
Nr.146, datë 4.10.2004

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT PARLAMENTAR PËR
SHQYRTIMIN DHE ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PËRBASHKËTA TË
OSBE/ODIHR-IT DHE KOMISIONIT TË VENECIAS PËR PËRMIRËSIMIN E KODIT
ZGJEDHOR, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR.134, DATË 1.7.2004,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 77 pikat 1, 2 e 3 të Kushtetutës dhe të neneve 22, 30, 88 dhe 164 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zgjatet deri më 5 nëntor 2004 afati i veprimtarisë së Komisionit Parlamentar për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias për përmirësimin e Kodit Zgjedhor, ngritur me vendimin e Kuvendit nr.134, datë 1.7.2004, i ndryshuar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.148, datë 7.10.2004

**PËR ZGJEDHJEN E DISA ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 44 të ligjit 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, si dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zgjidhen anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë:

1. Fatos Ibrahimi
2. Andis Harasani
3. Elisabeta Gjoni
4. Ardian Fullani
5. Ksenofon Krisafi
6. Tefta Çuçi

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRY ETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.660, datë 8.10.2004

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA SISTEMIMI E NDËRTIMI I RRUGËS “IBRAHIM DINÇI”, NË BASHKINË
ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private (truall dhe objekt), për sistemimin e ndërtimin e rrugës “Ibrahim Dinçi” në bashkinë e Elbasanit.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Elbasanit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqet 848 m² tokë/truall, vlerësuar në shumën 1 265 216 (një milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë, 124 m² banesë, vlerësuar në shumën 2 841 901 (dy milionë e tetëqind e dyzet e një mijë e nëntëqind e një) lekë dhe 12 m² dyqan, vlerësuar në shumën 326 860 (treqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) lekë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi në shumën 4 433 977 (katër milionë e katërqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.
4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri “Shpronësime për investime publike”, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 555 000 (pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë e të përballohet nga buxheti i vitit 2004, miratuar për bashkinë e Elbasanit.
6. Shpronësimi të përfundojë brenda muajit tetor 2004.
7. Punimet të përfundojnë në muajin shtator 2005.
8. Ngarkohen Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe kryetari i bashkisë së Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA SISTEMIMI E NDËRTIMI I
RRUGËS “IBRAHIM DINÇI” NË QYTETIN E ELBASANIT**

1. Për truallin

Nr.	Emri, mbiemri	Sip/tokë Truall/m ²	Çmimi i tokës/m ²	Vlera në lekë
1.	Katerina Spiro Laloshi Ali Rustem Laloshi Gazmend Rustem Laloshi Ylli Rustem Laloshi Kastriot Rustem Laloshi Etmond Rustem Laloshi Engjell Rustem Laloshi	848	1492	1 265 216

2. Për banesë

Nr.	Emri, mbiemri	Sip/tokë truall/m ²	Çmimi i objektit/m ²	Vlera e amortizimit	Vlera në lekë
1	Katerina Spiro Laloshi Ali Rustem Laloshi Gazmend Rustem Laloshi Ylli Rustem Laloshi Kastriot Rustem Laloshi Etmond Rustem Laloshi Engjell Rustem Laloshi	124 m ²	27 284	54 131	2 841 901

3. Për dyqanin

Nr.	Emri, mbiemri	Sip/tokë truall/m ²	Çmimi i objektit/m ²	Vlera e amortizimit	Vlera në lekë
1.	Katerina Spiro Laloshi	12	27 284	548	326 860

Vlera totale e shpronësimit

4 433 977 lekë

VENDIM

Nr.662, datë 8.10.2004

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHETËTËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË SË KUÇOVËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shetëtare, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë së Kuçovës, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e listës përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme shetëtare, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë së Kuçovës. Kjo listë, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, ka 105 (njëqind e pesë) fletë dhe përfundon me numrin rendor 556 (pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë).

2. Pronat me numër inventari nga 370 deri në 373 dhe prona me numër 401 të vazhdojnë të përdoren nga përdoruesit aktualë, në bazë të aktmarrëveshjeve të lidhura ndërmjet tyre dhe bashkisë së Kuçovës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Ngarkohen Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Ministri i Ekonomisë, kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryetari i bashkisë së Kuçovës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Fatos Nano**

VENDIM
Nr.663, datë 8.10.2004

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2004, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT PËR VAZHDIMIN E FINANCIMIT TË PROJEKTIT
TË REGJISTRIMIT FILLESTAR TË PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, zëri “Kosto lokale”, t’i shtohet fondi prej 9 000 000 (nëntë milionë) lekësh, për vazhdimin e financimit të projektit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme për periudhën 15 tetor deri në fund të vitit 2004.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr. 668, datë 8.10.2004

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE, NË BASHKINË E PËRRENJASIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohëshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i varrezave publike, në bashkinë e Përrenjasit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Përrenjasit .

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 3900 m² tokë/truall, vlerësuar në shumën e përgjithshme 3 120 000 (tremilionë e njëqind e njëzet mijë) lekë.

4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri “Investimeve për shërbime publike”, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 175 500 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë dhe të përballohet nga buxheti i vitit 2004, miratuar për bashkinë e Përrenjasit.

6. Shpronësimi të fillojë më datë 1 nëntor dhe të përfundojë më datë 30 nëntor 2004.
7. Ngarkohen Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe kryetari i bashkisë së Përrenjasit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E VARREZAVE
PUBLIK NË PËRRENJAS

Nr.	Emri, mbiemri	Sip. Tokë truall m ²	Njësia lekë m ²	Vlera lekë
1.	Shahin Rushan Kukli	3 900	800	3 120 000
	Totali			3 120 000

VENDIM
Nr.669, datë 13.10.2004

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.617, DATË 4.12.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR HEQJEN NGA ARMATIMI DHE PËRDORIMI TË NJË PJESE TË
ARMËVE, TEKNIKËS DHE PAJISJEVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE PËR
ASGJËSIMIN OSE ÇMONTIMIN DHE SHITJEN E TYRE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2001, "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.617, datë 4.12.2002 të Këshillit të Ministrave, në fund të tabelës, që i bashkëlidhet, të shtohet emërtimi i raketave portative, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

TABELA E ARMËVE, TEKNIKËS, PAJISJEVE DHE ARTIKUJVE TË TJERË TË FORCAVE
TË ARMATOSURA QË HIQEN NGA ARMATIMI DHE PËRDORIMI

Nr.	Emërtimi	Sasia
1	Raketa portative tip QW-01	16

VENDIM
Nr.670, datë 8.10.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.439, DATË 4.8.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 83 të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 "Për të huajt", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 19 e vendimit nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.673, datë 15.10.2004

PËR SHPALLJE DITË ZIE KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.8926, datë 22.7.2002 "Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës të Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre", me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen ditë zie kombëtare të ditës së premte, datë 15.10.2004, në nderim të viktimave, të aksidentit tragjik të datës 14.10.2004, në Urën e Bicajve, në afërsi të Fushë-Arrëzit.

2. Në të gjitha institucionet shtetërore dhe publike, flamuri kombëtar të ulet në gjysmë shtize. Gjithashtu, në orën 12⁰⁰ të ndërpritet çdo veprimtari dhe të mbahen tri minuta heshtje, në nderim të viktimave.

3. Të gjitha veprimtaritë artistike, kulturore dhe sportive, të planifikuara për këtë ditë, të pezullohen dhe të shtyhen për një datë të mëvonshme.

4. Ftohen të gjitha kanalet radiotelevizive, publike dhe private, të transmetojnë muzikë funebre.

5. Ftohen të gjitha institucionet fetare të kryejnë shërbesa, në kujtim të viktimave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.267, datë 30.9.2004

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADIO VENDORE PRIVATE “SPORT”

SUBJEKTIT: SHOQËRIA “RADIO SPORT” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, vendimit nr.254, datë 31.8.2004 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira, të shpallura publikisht në muajin maj, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Radio Sport”, me vendndodhje në qytetin e Tiranës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore, me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Albert Minga

VENDIM
Nr.268, datë 30.9.2004

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “STAR”

SUBJEKTIT: SHOQËRIA “STAR-E.L.I” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së, nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Star-E.L.I.” sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Tiranës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetritimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Albert Minga

VENDIM
Nr.269, datë 30.9.2004

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “EGNATIA KABËLL”

SUBJEKTIT: SHOQËRIA “EGNATIA-RADIO TV KABËLL” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Egnatia-Radio Tv Kabëll”sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Elbasanit, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Albert Minga

VENDIM
Nr.270, datë 30.9.2004

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “ILIRIA”

SUBJEKTIT: Z. EDUART AZIZOLLI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, z. Eduart Azizolli, me vendndodhje në qytetin e Beratit, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Albert Minga

VENDIM
Nr.271, datë 30.9.2004

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “LISSUS”

SUBJEKTIT: Z. PËLLUMB TAKA

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, z. Pëllumb Taka, me vendndodhje në qytetin e Lezhës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETARI
Albert Minga

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit shpall kërkesën “Për shpronësimin e pronarëve që preken nga sistemimi i shkarjeve në kilometrin 89 Hotolisht, të ndodhura në segmentin rrugor Librazhd-Qukës”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

Me anën e këtij publikimi në shtyp, kërkohet të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE
QARKU ELBASAN
RRETHI LIBRAZHD
KOMUNA HOTOLISHT

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË SISTEMIT TË SHKARJES NË
KM 89 (HOTOLISHT) NË SEGMENTIN RRUGOR LIBRAZHD-QUKËS

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Tokë bujqësore dhe kulturë bujqësore

Nr.	Pronari			Fshati ZK	Nr. i pas.	Tokë bujqësore Sip.m ²	Çmimi Lek/m ²	Vlera në lekë	Kulturë bujqësore Sip m ²	Çmimi l/m ²	Vlera në lekë	Totali Në lekë
	Emri	Atësia	Mbiemri									
1.	Lutfi	Shaban	Quku	3843	896	392	114	44688	500	7	3500	48188
		Shuma				392		44688	500		3500	48188

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit shpall kërkesën “Për shpronësimin e pronarëve që preken nga rehabilitimi i shkarjeve në Barmash, të ndodhura në segmentin rrugor Ersekë-Leskovic”.

Subjekti kërkuar i këtij shpronësimi është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

Me anën e këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE
QARKU KORÇË
RRETHI Ersekë
KOMUNA Barmash

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË SISTEMIT TË SHKARJEVE NË
BARMASH, TË SEGMENTIT RRUGOR ERSEKË-LESKOVIC

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Tokë bujqësore dhe kulturë bujqësore

Nr.	Pronari			Fshati ZK	Nr. i pas.	Tokë bujqësore Sip.m ²	Çmimi Lek/m ²	Vlera në lekë	dru frutorë copë	Çmimi Lekë/copë	Vlera në lekë	Totali në lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri										
1.	Hajro	Rrushan	Muhameti	1119	36	1300	500	650000	4	1556	6224	656224	Plot[sim dokumentacioni
		Shuma				1300		650000	500			656224	48188

Shënim: Brenda afatit ligjor 15 ditë pas publikimit, pronari duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm ligjor (certifikatë dhe kartelë) të noterizuara pranë sektorit të shpronësimeve në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

DOLI NGA SHTYPI

PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500
PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E DREJTËSISË	400

Doli nga shtypi më 21.10.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë